Njoftim!

Në HK-Trainkos Sh.A., vazhdojnë të jenë të hapura këto konkurse:

- **Inxhinier i Elektros në Mirëmbajtjen e Mjeteve Lëvizëse** - 1 punëtor
- **Konduktor** - 6 punëtorë

Aplikimin tuaj mund ta bëni edhe në këto adresa emaili:

- rekrutimet@trainkos.com
- apliko.trainkos@trainkos.com

P.S. Meqë adresa apliko.trainkos@trainkos.com ka një problem teknik momental, ju kërkojmë

që gjithë ata që kanë kryer aplikimin më herët ta bëjnë edhe një here tek

rekrutimet@trainkos.com.

Aplikacionin mund ta shkarkoni në faqen zyrtare

https://www.trainkos.com/publikimet/punesimi/

(shih emërtimin "Aplikacion për punësim TRAINKOS").

Ju falënderojmë për mirëkuptimin tuaj!

TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 364
Dt. 28.03.2025
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

trainkos

Hekurudhat e Kosovës

Datë: 28.03.2025

Bazuar në nenin 8 te Ligjit të Punës, nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) NR. 01/2024 dhe plotësim ndryshimin e UA 03/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit ne Sektorin Publik dhe në bazë të nenit 17, paragrafi 3, pika 1 të Statutit të Kompanisë me Nr. I/02 të datës 19.01.2024, Kryeshefi Ekzekutiv shpall:

KONKURS

Titulli i pozitës së punës: Inxhinier i Elektros në Mirëmbajtjes e Mjeteve Lëvizëse
Institucioni: Hekurudhat e Kosovës – Trainkos - SH.A.
Numri i referencës: 13 – 28.03.2025.
Tipi i Akt Emërimit të punës: Sipas Ligjit i Punës NR. 03/L-212, plotësim ndryshimi UA 01/2024 dhe UA03/2025.
Titulli i mbikëqyrësit: Shefi i Njësisë së Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse
Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 muaj.
Koeficienti/Paga: 550 Euro
Procedura e aplikimit: Publik
Numri i kërkuar: 1
Vendi: Fushë Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Jep udhëzime për mënyrën e organizimit të punëve për mirëmbajtje në sferën e elektros;
- Koordinon punën me Shefin e Njësisë për mirëmbajtje sa më efikase;
- Kompleton, ruan dhe zbaton dokumentet teknike të lokomotivave;
- Paraqet nevojën për furnizim me pjesë rezervë dhe materiale shpenzuese;
- Përcjell aplikimin e dispozitave të mirëmbajtjes të mjeteve tërheqëse në sferën e elektros;
- Bën plane vjetore dhe periodike për mirëmbajtjen e mjeteve tërheqëse (investive dhe ciklike) dhe përcjell realizimin e tyre;
- Organizon, harton dhe vërteton nevojën për pjesë rezervë (pjesë, vegla dhe pajisje);
- Analizon defektet në mjetet tërheqëse dhe merr masa për mirëmbajtjen e tyre;
- Përgatit raportet ditore, javore, mujore dhe periodike; j) Sipas nevojës angazhohet në trajnimin e stafit për mirëmbajtje;
- Prezanton gjatë pranim- dorëzimit të lokomotivave;
- Kryen edhe detyra dhe obligime të parapara me akte normative tjera dhe sipas kërkesave nga Shefi i Njësisë së Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse;
- Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive i përgjigjet Shef i Njësisë së Mirëmbajtjes së Mjeteve Lëvizëse.

Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Të ketë të përfunduara studimet universitare në drejtimin e Inxhinierisë së Elektros;
- Të ketë të bashkangjitur CV-në personale;
- Të ketë të përfunduar provimin profesional;
- Të ketë përvojë pune pas diplomimit së paku tri (3) vite;
- Të ketë njohuri të mira për mirëmbajtjen e lokomotivave dhe trenave motorikë;
- Të posedojë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe organizative;
- Të jetë konfidencial dhe i angazhuar në kryerjen e detyrave;
- Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe në grup;
- Të ketë njohuri të mira në përdorimin e programeve kompjuterike si Word, Excel, Auto Cad, Internet, Outlook, etj.; i) Njohja e gjuhës angleze e preferuar.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon

se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;

- Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike).Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik ;
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit;
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion;

Mënyra e aplikimit:

• Aplikimi është online përmes postes elektronike (apliko.trainkos@trainkos.com). Aplikacionin mund ta shkarkoni nga www.Trainkos.com. Ngarkoni dokumentet sipas kërkesave ne konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuat vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri shkruani ne e-mailin (apliko.trainkos@trainkos.com) për te vërtetuar aplikim tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mail njoftues).

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

• Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (apliko.trainkos@trainkos.com).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

• Testimi me shkrim – deri ne shtatëdhjetë (70) pikë
• Intervista – deri ne njëzetë (20) pikë
• Jetë përshkrimi (CV) - deri në dhjetë (10) pikë

Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak:

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet në portalin e rekrutimit elektronik (apliko.trainkos@trainkos.com) duke i respektuar afatet UDHËZIM ADMINISTRATIV MFPT-NR. 01 /2024 PËR RREGULLIMIN E PROCEDURAVE TË KONKURSIT NË SEKTORIN PUBLIK.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit, ju lutemi të keni parasysh se sistemi nuk mund të pranojë email-e me madhësi më të madhe se 10 MB. Prandaj, ne nuk marrim përgjegjësi për aplikacionet që nuk mund të dorëzohen për shkak të madhësisë së tepruar. Aplikacionet që dorëzohen pas afatit, si dhe ato që janë të mangëta ose nuk përmbushin kriteret e specifikuara, do të refuzohen.

Titulli i pozitës së punës: Konduktor
Institucioni: Hekurudhat e Kosovës – Trainkos SH.A.
Numri i referencës: 14 – 28.03.2025.
Tipi i Akt Emërimit të punës: Sipas Ligjit i pinës NR. 03/L-212, plotësim ndryshimi UA 01/2024 dhe UA03/2025.
Titulli i mbikëqyrësit: Shef i Njësisë së Personelit të Transportit të Udhëtarëve
Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 muaj.
Koeficienti/Paga: 400 Euro
Procedura e aplikimit: Publik
Numri i kërkuar: 6
Vendi: Fushë Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbikëqyr vagonët dhe inventarin e tyre gjatë orarit të punës
- Merr pjesë në pranim - dorëzimin e vagonëve të udhëtarëve
- Bën lidhjen e lokomotivës me vagonë në rastet e ndërrimit të drejtimit të trenit sipas OLT-së
- Kryen punët manovruese në trenat e udhëtarëve, sipas nevojës nëpër stacionet kur treni i udhëtarëve merr dhe lë vagonë të mallrave
- Jep bileta nëpër stacione sipas Udhëzimit për aplikim të Rregullores së Transportit të Udhëtarëve
- Bën vendosjen dhe heqjen e sinjalit fundor në garniturën e trenit
- Së bashku me makinistët bën pastrimin dhe mirëmbajtjen e dhomës së pushimit në F. Kosovë, H. Elezit dhe Pejë
- Përkujdeset për hyrjen dhe zbritjen e sigurt të udhëtarëve në tren dhe përkujdeset për vendosjen e tyre nëpër vagonë
- Jep sqarime të nevojshme udhëtarëve në mënyrë racionale
- Kyç dritat në vagonë gjatë natës
- Përgjigjet për siguri në trafik sipas rregullave të aplikueshme ligjore
- Përkujdeset që dyert e vagonëve të jenë të mbyllura gjatë lëvizjes
- Kujdeset për pastrimin e vagonëve të udhëtareve gjatë pauzave dhe në stacionin hekurudhor përfundimtar
- Furnizon udhëtarët me bileta sipas rregullave të aplikueshme
- Dorëzon të hollat nga shitja e biletave me kohë ne Departamentin e Financave dhe jep raporte ditore dhe mujore mbi shitjen te Shef i Njësisë së Personelit të Transportit të Udhëtarëve
- Kryen edhe detyra dhe obligime të parapara me akte normative tjera dhe sipas kërkesave nga Shef i Njësisë së Personelit të Transportit të Udhëtarëve
- Harton raporte pune të rregullta dhe periodike
- Për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësive i përgjigjet Shefit të Njësisë së Personelit të Transportit të Udhëtarëve.

Kushtet dhe kriteret, kualifikimi, përvoja e punës, aftësitë dhe shkathtësitë e tjera:

- Të ketë të përfunduar Shkollën e Mesme
- Të ketë të bashkangjitur CV-në personale;
- Të ketë të përfunduar provimin profesional
- Të posedojë aftësi të mira komunikuese dhe organizative
- Të jetë konfidencial dhe i angazhuar në kryerjen e detyrave
- Të ketë aftësi për të punuar nën presion dhe në grup
- Njohje elementare të gjuhës angleze.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre:

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/çertifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal;
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike).Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një **vetë deklaratë** me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik ;
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit;
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion;

Mënyra e aplikimit:

• Aplikimi është online përmes postes elektronike (apliko.trainkos@trainkos.com). Aplikacionin mund ta shkarkoni nga www.Trainkos.com. Ngarkoni dokumentet sipas kërkesave ne konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuat vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri shkruani ne e-mailin (apliko.trainkos@trainkos.com) për te vërtetuar aplikim tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mail njoftues).

Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët:

• Përmes postës elektronike (apliko.trainkos@trainkos.com).

Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:

Duke u mbështetur ne Udhëzimit Administrativ MFPT-NR. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Rregullores së Marrëdhënies së Punës dhe Procedurës Disiplinore në Hekurudhat E Kosovës - Trainkos SH.A., NR. I/126 e datës 29.08.2024.

Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak:

Lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për pranim do të njoftohen përmes postës elektronike (apliko.trainkos@trainkos.com) duke i respektuar afatet e Udhëzimit Administrativ MFPT-NR. 01 /2024 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik dhe Udhëzimin Administrativ (MFPT) Nr. 03/2024 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MFPT) NR. 01/2024 për Procedurat e Konkursit në Sektorin Publik.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit, ju lutemi të keni parasysh se sistemi nuk mund të pranojë email-e me madhësi më të madhe se 10 MB. Prandaj, ne nuk marrim përgjegjësi për aplikacionet që nuk mund të dorëzohen për shkak të madhësisë së tepruar. Aplikacionet që dorëzohen pas afatit, si dhe ato që janë të mangëta ose nuk përmbushin kriteret e specifikuara, do të refuzohen.

Data e aplikimit mbetet e hapur deri më datën 15.04.2025 ora 16:00
Fushë Kosovë, 28.03.2025

Kryeshef Ekzekutiv
Agron Stulovci